

Syllabusi i lëndës

Lënda: E Drejta Civile

Programi i studimit: Teologji Islame

Numri i ECTS kredive: 4 ECTS Kredi

Niveli dhe lloji i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës: 305

Fondi i orëve: 2+0

VITI AKADEMIK :2026/2027

Semestri: -V-

Mësimdhënësi: Mr. sci. Vedat Shabani, **kontakti:** Tel: +383 (0) 44 195 331, e-mail: vedat_sh@hotmail.com

Përshkrim i shkurtër i lëndës

Lënda (**E Drejta Civile – Pjesa e Përgjithshme**) e cila mësohet në vitin e III-të semestrin e V-të, përfshinë trajtimin në mënyrë bashkëkohore të parimeve të drejtës civile ne përgjithësi që janë bazë për të gjitha pjesët tjera të drejtës civile. Instucionet juridike që janë objekt i të drejtës civile në përgjithësi do të trajtohen duke u mbështetur në të drejtën pozitive të Kosovës dhe të drejtën civile komparative në sistemin Kontinental dhe atë të Common Law. Ligjëratat dhe seminarat nga kjo lëndë do të mbahen një herë në javë nga tri orë. Kjo lëndë është lëndë zgjedhore. Studentëve u ofrohen njohuri teorike dhe praktike për çështjet e të drejtës civile.

Qëllimi i lëndës

Qëllimet e lëndës konsistojnë në dhënien e mundësisë studentëve të Studimeve Islame-bachelor për njohuri rreth të drejtës civile dhe për të zhvilluar vetëdijen te studentët për zbatimin e dispozitave me të cilat rregullohen çështjet juridiko-civile. Studentët do të kenë mundësi që me qasje logjike dhe në mënyrë analitike t'i zgjidhin detyrat të cilat kërkohen në fushën e të drejtës civile Te studentët do të zhvillohen shkathtësitë për qasje kritike për ligjin dhe argumentimin ligjor në fushën e të drejtës civile.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të keni mundësi:

- Të pajiset me njohuri të mjaftueshme rreth lëndës e Drejta Civile Laike
- Të njihen me sistemin legjislativ në Kosovë.
- Të jenë në gjendje të bëjnë studime komparative mes të Drejtës Islame dhe të Drejtës Laike.

- Të njihen me sistemet e të drejtës në përgjithësi

Metodologjia e mësimdhënies:

E drejta civile do të mësohet përmes ligjëratave dhe seminareve, ushtrimeve duke mos i përjashtuar edhe forma tjera të mundshme. Ligjërata do të paraqes prezantimin e rregullave themelore hyrëse dhe të drejtën pozitive të Kosovës, si dhe duke bërë krahasime edhe në të drejtën komparative të institucioneve të drejtës civile, sidomos me të drejtën civile islame. Seminaret do të jenë një proces interaktiv i mësimi për studentët, duke u bazuar në studimin e pavarur të materies nga ana e studentit nën mbikëqyrjen nga ana e mësimdhënësit të lëndës.

Përmbajtja e lëndës:

Java e pare:

E DREJTA CIVILE

Nocioni dhe emërtimi i të Drejtës Civile, Objekti metoda dhe sistemi i së Drejtës Civile, Institucionet themelore të së Drejtës Civile, E drejta dhe ekonomia

Java e dyte:

OBJEKTI DHE PARIMET E TË DREJTËS CIVILE

Objekti i të drejtës, parimet e të drejtës civile, të drejtës sendore, të drejtës detyrimore dhe të drejtës trashëgimore.

Java e tretë:

ZHVILLIMI HISTORIK I TË DREJTËS CIVILE

E Drejta Civile dhe kodifikimet më të rëndësishme në botë.

Java e katërt:

E Drejta dhe Ekonomia, e Drejta Private dhe e Drejta Publike, e Drejta Civile në sistemin Common Law, unifikimi i të Drejtës Civile në Evropë, marrëdhëniet e të Drejtës Civile me degët tjera të së drejtës.

Java e pestë:

NORMAT JURIDIKE DHE INTERPRETIMI I TYRE

Ndarja e normave juridike, llojet e normave juridike

Java e gjashtë:

BURIMET E TË DREJTËS CIVILE

Ligji në kuptimin e ngushtë si burim i së drejtës civile, hyrja në fuqi dhe abrogimi i ligjeve, veprimi retroaktiv i ligjit (veprimi prapaveprues), shtrirja (veprimi) territoriale e ligjit, aktet

nënligjore si burim i së Drejtës Civile, e Drejta zakonore burim pozitiv subsidiar i së Drejtës Civile, Praktika gjyqësore burim i së Drejtës Civile, Doktrina si burim i së Drejtës Civile

Java e shtatë:

Kollokviumi i parë

Java e tetë:

MARRËDHËNIA JURIDIKO-CIVILE

Subjektet e marrëdhënies juridiko-civile, Personi fizik si subjekt i së drejtës, Personat juridik si subjekt të së drejtës, Zotësia juridike zotësia për të vepruar dhe zotësia e deliktit, Objekti si element i marrëdhënieve juridiko – civile, Krijimi dhe shuarja e marrëdhënieve juridiko – civile.

Java e nëntë:

OBJEKTI I MARRËDHËNIES JURIDIKE CIVILE

Sendet, ndarja e sendeve, të drejtat personale, veprimet e njerëzve me karakter pasuror, e drejta e kërkesës me karakter pasuror.

Java e dhjetë:

KRIJIMI DHE SHUARJA E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE

Faktet juridike, ndarja e fakteve juridike, supozimet, veprimet e palejuara.

Java e njëmbëdhjete:

LLOJET E TË DREJTAVE SUBJEKTIVE CIVILE

Të drejtat absolute, të drejtat personale, pronësi industriale, marka tregtare, burimet e detyrimeve.

Java e dymbëdhjete

PUNËT JURIDIKE DHE MODIFIKIMI I TYRE

Nocioni i punëve juridike, Modifikimi i punëve juridike, Kushti, Afati, Urdhri.

Java e trembëdhjetë:

PAVLEFSHËMRIA E PUNËVE JURIDIKE

Pavlefshmëria absolute, pavlefshmëria absolute e pjeshme, pasojat juridike, punet juridike relativisht të pavlefshme, anulimi i punëve juridike, pasojat e anulimit.

Java e katërbëdhjetë:

Fitimi, ushtrimi dhe mbrojtja e të drejtave subjektive civile

Java e pesëmbëdhjetë:

Parapërgatitje për provimin final

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Abdulla Aliu, E Drejta Civile, Prishtinë 2013

Literatura konsultative:

1. Juliana Latifi, E Drejta Civile – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2005
2. Peter Bydlinski, E Drejta Civile – Vllimi I, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2015
3. Ejup Haziri, E Drejta Civile Islame, Prishtinë 2014

Ligjet:

1. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës. Gazeta zyrtare nr. 16 datë 19.06.2012 dhe ka hyr në fuqi më datë 19.12.2012
2. Ligji Nr. 03/L-154, për Pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore i Kosovës. Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 57, datë 04.08.2009 dhe ka hyr në fuqi më 16.08.2009